



**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë



National Endowment for Democracy  
Supporting freedom around the world

# BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË SFIDAT E SIGURISË PUBLIKE NË KOSOVË

MAJ 2020



Autore: Donika Marku

Rishikimi i Brendshëm: Mentor Vrajolli dhe Plator Avdiu

---

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i të gjitha materialeve që botohen nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutem kontaktoni në: [info@qkss.org](mailto:info@qkss.org) ose +381 38 221 420. Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e përgjigjeve të nxjerra nga të anketuarit dhe ai vetëm demonstroi mënyrën se si njerëzit i perceptojnë institucionet. Raporti në asnjë mënyrë nuk paraqet ndonjë vlerësim përfundimtar të cilësisë së punës së institucioneve të përfshira në këtë studim. Ai do të shërbejë si instrument për to në adresimin e mangësive të mundshme, por edhe si tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me qytetarët. Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptime të të anketuarve dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Mendimet e shprehura në këtë raport nuk paraqesin domosdoshmërisht pikëpamjet e fondacionit Ndihma Kombëtare për Demokraci (NED)

# PËRMBAJTJA

<b>GJETJET KYÇE</b>	<b>6</b>
<b>HYRJE</b>	<b>7</b>
<b>PERCEPTIMET NDAJ KËRCËNIMEVE TË SIGURISË KOMBËTARE</b>	<b>8</b>
<b>RREZIQET NDAJ SIGURISË PUBLIKE NË KOSOVË</b>	<b>11</b>
MIGRIMI I QYTETARËVE JASHTË VENDIT	11
AKSIDENTET E TRAFIKUT	13
QENTË ENDACAKË	14
FATKEQËSITË NATYRORE	15
PLAÇKITJA E SHTËPIVE DHE BANESAVE	16
ARMËMBAJTJA PA LEJE	17
FAJDET	18
VRASJET	19
NGACMIMET SEKSUALE	20
DHUNA NË SHKOLLA	21
DHUNA NË FAMILJE	22
<b>PERCEPTIMET KUNDREJT REALITETIT</b>	<b>24</b>
<b>PERIMETRI I SIGURISË</b>	<b>27</b>
<b>PRITSHMËRITË NË INSTITUCIONET: REKOMANDIMET</b>	<b>32</b>
<b>METODOLOGJIA E BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË 2019</b>	<b>35</b>

# TABELA E FIGURAVE

Figura 1. Kërcënimet kryesore të brendshme të sigurisë në pyetjen e hapur	9
Figura 2 - Shqetësimet kryesore të sigurisë socio-ekonomike	9
Figura 3. Përceptimi i Rrezikimit të Sigurisë nga mungesa e sundimit të Ligjit	9
Figura 4. Rreziqet më të mëdha të brendshme ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë.	9
Figura 5. Ekstremizmi i dhunshëm si shqetësim kyç	10
Figura 7. Ekstremizmi i dhunshëm si shqetësim i brendshëm	10
Figura 6. Ndotja e ajrit t si shqetësim kyç	10
Figura 8.Përceptimi publik ndaj migrimit si rrezik i lartë për sigurinë publike	12
Figura 10.Përceptimi publik ndaj migrimit si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës	12
Figura 11.Përceptimi publik ndaj migrimit si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit	12
Figura 9.Përceptimi publik ndaj migrimit si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë	12
Figura 12.Përceptimi publik ndaj aksidenteve trafikore si rrezik i lartë për sigurinë publike	13
Figura 14.Përceptimi publik ndaj aksidenteve trafikore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës	13
Figura 16.Përceptimi publik ndaj aksidenteve trafikore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit	13
Figura 15.Përceptimi publik ndaj aksidenteve trafikore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësisë etnike	13
Figura 13.Përceptimi publik ndaj aksidenteve trafikore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë	13
Figura 17.Përceptimi publik ndaj qenve endacakë si rrezik i lartë për sigurinë publike	14
Figura 19.Përceptimi publik ndaj qenve endacakë si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës	14
Figura 20.Përceptimi publik ndaj qenve endacakë si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësisë etnike	14
Figura 21.Përceptimi publik ndaj qenve endacakë si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit	14
Figura 18. Përceptimi publik ndaj qenve endacakë si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë	14
Figura 22. Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike	15
Figura 24. Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës	15
Figura 28.Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit	15
Figura 25.Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësisë etnike	15
Figura 23.Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë	15
Figura 29. Sa të rrezikuar ndihen të anketuarit nga plaçkitja e shtëpive/banesave	16
Figura 32.Sa të rrezikuar ndihen të anketuarit nga plaçkitja e shtëpive/banesave, sipas zonës	16
Figura 34.Sa të rrezikuar ndihen të anketuarit nga plaçkitja e shtëpive/banesave, sipas rajonit	16
Figura 33.Sa të rrezikuar ndihen të anketuarit nga plaçkitja e shtëpive/banesave, sipas përkatësisë etnike	16
Figura 31.Sa të rrezikuar ndihen të anketuarit nga plaçkitja e shtëpive/banesave, sipas gjinisë	16
Figura 34.Përceptimi publik ndaj posedimit të armeve pa leje si rrezik i lartë për sigurinë publike	17
Figura 36.Përceptimi publik ndaj posedimit të armeve pa leje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës	17
Figura 38.Përceptimi publik ndaj posedimit të armeve pa leje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit	17
Figura 37.Përceptimi publik ndaj posedimit të armeve pa leje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësisë etnike	17
Figura 35.Përceptimi publik ndaj posedimit të armeve pa leje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë	17
Figura 39.Përceptimi publik ndaj fajdeve si rrezik i lartë për sigurinë publike.	18
Figura 41.Përceptimi publik ndaj fajdeve si rrezik i lartë, sipas zonës	18

Figura 43.Përceptimi publik ndaj fajdeve si rrezik i lartë, sipas rajonit	18
Figura 42.Përceptimi publik ndaj fajdeve si rrezik i lartë, sipas përkatësisë etnike	18
Figura 40.Përceptimi publik ndaj fajdeve si rrezik i lartë, sipas gjinisë	18
Figura 44. Përceptimi publik ndaj vrasjeve si rrezik i lartë për sigurinë publike	19
Figura 46. Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës	19
Figura 48.Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit	19
Figura 47.Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësisë etnike	19
Figura 45.Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë	19
Figura 49.Përceptimi publik ndaj ngacmimit seksual si rrezik i lartë për sigurinë publike	20
Figura 52.Përceptimi publik ndaj ngacmimit seksual si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit	20
Figura 51.Përceptimi publik ndaj ngacmimit seksual si rrezik i lartë për sigurinë publike, përkatësisë etnike	20
Figura 50.Përceptimi publik ndaj ngacmimit seksual si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë	20
Figura 53.Përceptimi publik ndaj dhunës në shkolla si rrezik i lartë për sigurinë publike	21
Figura 55.Përceptimi publik ndaj dhunës në shkolla si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës	21
Figura 57.Përceptimi publik ndaj dhunës në shkolla si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit	21
Figura 56. Përceptimi publik ndaj dhunës në shkolla si rrezik i lartë për sigurinë publike,sipas përkatësisë etnike	21
Figura 54. Përceptimi publik ndaj dhunës në shkolla si rrezik i lartë për sigurinë publike,sipas gjinisë	21
Figura 58.Përceptimi publik ndaj dhunës në familje si rrezik i lartë për sigurinë publike	22
Figura 60.Përceptimi publik ndaj dhunës në familje si rrezik i lartë, sipas zonës	23
Figura 62.Përceptimi publik ndaj dhunës në familje si rrezik i lartë për sigurinë publike,sipas rajonit	23
Figura 61.Përceptimi publik ndaj dhunës në familje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësisë etnike	23
Figura 59.Përceptimi publik ndaj dhunës në familje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë	23
Figura 63.Sa të sigurt ndihen te anketuarit në shtëpinë/banesën, lagjen, qytetin/ fshatin e tyre	27
Figura 64.Sa të sigurt ndihen te anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas zonës	28
Figura 66.Sa të sigurt ndihen te anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas rajonit	28
Figura 65.Sa të sigurt ndihen te anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas përkatësisë etnike	28
Figura 68.Sa të sigurt ndihen te anketuarit në lagjen e tyre, sipas zonës	29
Figura 69.Sa të sigurt ndihen te anketuarit në lagjen e tyre, sipas përkatësisë etnike	29
Figura 70.Sa të sigurt ndihen te anketuarit në lagjen e tyre, sipas rajonit	29
Figura 67.Sa të sigurt ndihen te anketuarit në lagjen e tyre, sipas gjinisë	29
Figura 71.Sa të sigurt ndihen te anketuarit në qytetet/fshatrat e tyre, sipas zonës	30
Figura 72.Sa të sigurt ndihen te anketuarit në qytetet/fshatrat e tyre, sipas rajonit	30
Figura 74.Sa te sigurt ndihen te anketuarit në Kosove (niveli kombëtar), sipas zonës	31
Figura 75.Sa te sigurt ndihen te anketuarit në Kosove (niveli kombëtar), sipas përkatësisë etnike	31
Figura 76.Sa te sigurt ndihen te anketuarit në Kosove (niveli kombëtar), sipas rajonit	31
Figura 73.Sa te sigurt ndihen te anketuarit në Kosove (niveli kombëtar), sipas gjinisë	31

# GJETJET KYÇE



Migrimi i qytetarëve jashtë vendit (71 për qind), aksidentet e trafikut (60 për qind) dhe qentë endacak (58 për qind) radhiten si rreziqet më të larta të sigurisë publike sipas perceptimeve nga të anketuarit;



Të anketuarit në zonat urbane shprehën shqetësim më të madh rreth aksidenteve të trafikut se ata në zonat rurale. Shqetësim më i madh vërehet tek të anketuarit në rajonin e Pejës dhe Ferizajt;



Shqetësim më i madh për rrezikimin e sigurisë publike nga qentë endacak është vërejtur tek të anketuarit në zonat urbane (63 për qind) krahasuar me ata në zona rurale (50 për qind);



Gati gjysma e të anketuarve , 47 për qind, e shohin posedimin e armëve pa leje si një rrezik të lartë të sigurisë publike. Të anketuarit në zonat urbane janë shprehur më të shqetësuar për këtë dukuri, ku përderisa në zonat urbane 51 për qind e të anketuarëve e shohin armëmbajtjen pa leje si shqetësim për sigurinë publike, në zonat rurale kjo përqindje bie në 42 për qind;



Në vitin 2019 ka pasur një rritje të perceptimit të vrasjeve si rrezik i lartë i sigurisë publike në Kosovë (rreth 40 për qind), krahasuar me vitin 2018 (35.6 për qind). Të anketuarit në zonat urbane ndihen më të kërcënuar nga vrasjet se sa të anketuarit që jetojnë në zonat rurale;



Barometri regjistroi rritje të perceptimit të plaçkitjes së shtëpive dhe banesave si shqetësim të sigurisë publike;



Dhuna në familje renditet si dukuria që më së paku shihet si rrezik nga qytetarët (34 për qind) duke mbetur mbrapa dhunës në shkolla me 35 për qind dhe ngacmimeve seksuale me 37 për qind.

Të anketuarit në zona urbane janë shumë më të shqetësuar (40 për qind) rreth dhunës në familje se sa të anketuarit në zonat rurale (27 për qind).



Përqindja e të anketuarve që raportuan se ndihen të sigurt në qytetet/fshatrat e tyre po rritet gradualisht. Derisa në vitin 2018, rreth 79 për qind e të anketuarve u shprehën se se ndiheshin të sigurt në qytetin e tyre, në vitin 2019, kjo shifër u rrit në 84 përqind.

BKS 2019 ka gjetur se të anketuarit kosovarë ndihen më të sigurt në shtëpitë/banesat e tyre dhe lagjet e tyre (88 për qind), krahasuar me qytetin (83 për qind) dhe Kosovën (61 për qind).

Në vitin 2019 ka pasur një rritje prej tre përqind tek të anketuarit që janë shprehur se ndihen të sigurt në shtëpitë e tyre, duke shënuar kështu një trend pozitiv sa i përket sigurisë në shtëpi. Po ashtu, vërehet se ka rritje tek të anketuarit që u shprehen se ndihen më të sigurt në lagjen e tyre, duke pasur kështu një përqindje të njëjtë të ndjenjës së sigurisë në shtëpi dhe lagje (88 për qind).

Barometri në 2019, ka regjistruar një rritje të lartë tek të anketuarit që janë shprehur se ndjehen të sigurt në Kosovë. Ndonëse në vitin 2018 rreth 52 përqind e të anketuarve thanë se ndihen të sigurt në Kosovë, në vitin 2019, rreth 61 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se ndjehen të sigurt në Kosovë.

## Rekomandime:

- Institucionet duhen të zotohen në largimin e armëve ilegale nga duart e qytetarëve;
- Institucionet duhet të punojnë në rritjen e ndriçimit publik
- Rritja e pranisë së Policisë së Kosovës nëpër lagje;
- Vendosija e kamerave të sigurisë në hapësirat publike në të gjitha rajonet e Kosovës;
- Modernizimi i Qendrës së Thirrjeve në PK;
- Institucionet e sigurisë duhen të rrisin bashkëpunimin me qytetarët përmes rrjeteve sociale dhe aplikacioneve për përmirësim të sigurisë publike;
- Duhet të vazhdoj programi i Kapjes, Sterilizimit, Vaksinimit si dhe Lëshimit (KSVL) për qentë endacak në baza vjetore;

# HYRJE

Siguria është një e drejtë themelore e njeriut. Ndjesia e sigurisë apo e pasigurisë ndikon fuqishëm në shëndetin fizik dhe mendor dhe mirëqenien e njerëzve <sup>1</sup> dhe mund të shpie në rritjen e besimit/mosbesimit, që ndikon në socializimin e qytetarëve dhe ndjenjën e komunitetit. <sup>2</sup> Si rrjedhojë, QKSS-ja u ka kushtuar vëmendje të veçantë perceptimeve të qytetarëve në lidhje me sigurinë publike dhe sigurinë personale, që nga viti 2012 kur u lansua për herë të parë Barometri Kosovar i Sigurisë.

Ky edicion i posaçëm i Barometrit Kosovarë të Sigurisë (BKS) përbëhet nga katër kapituj. Raporti fillon me shpalosjen e perceptimeve të qytetarëve rreth shqetsimeve të sigurisë kombëtare. Kapitulli i dytë shpalos perceptimet e qytetarëve rreth sigurisë publike. Rrjedhimisht, kapitulli i tretë bën një lidhje në mes të perceptimeve të qytetarëve lidhur me shqetësimet dhe problemet e sigurisë publike dhe realitetit, duke analizuar arsyet që mund të kenë ndikuar në këto perceptime. Ndërsa, kapitulli i fundit ofron një varg rekomandimesh, masash që duhen ndërmarrë për të përmirësuar sigurinë publike në Kosovë.

Elemente të ndryshme ndikojnë në perceptimet e qytetarëve në lidhje me sigurinë publike. Padyshim që qëndrimet e tilla formësohen nga përvoja personale. Megjithatë, nuk mund të injorohet rëndësia e mediave dhe rrjeteve sociale në formësimin e opinionëve të qytetarëve. Perceptimet mund të lidhen me karakteristikat personale të tilla si gjinia, përkatësia etnike, zona dhe rajoni ku të anketuarit jetojnë. Prandaj, përtej analizave të përgjithshme të të dhënave, ky edicion përfshin edhe analiza të kryqëzuara të kërcënimeve të ndryshme të sigurisë nacionale dhe publike me karakteristika personale të të anketuarëve.



1 Stafford, M., Chandola, T., dhe Marmot, M., 2007, 'Lidhja ndërmjet frikës nga krimi dhe shëndetit mendor dhe funksionimit fizik', *Journal of Public Health*, 97 (11), f. 2076-208

2 Healey, J. (2012) Marrja e riskut dhe siguria personale. Thirroul, N.S.Ë.: Spinney Press (Çështje në Shoqëri). I disponueshëm në: <http://search.ebscohost.com/login.aspx?direct=true&AuthType=ip,url,cookie&db=nlebk&AN=473049&site=ehost-live> (Qasur më: 19 prill 2020)

# PERCEPTIMET NDAJ KËRCËNIMEVE TË SIGURISË KOMBËTARE

BKS-ja gjatë vitit 2019 ka bërë matjen e perceptimeve të qytetarëve të Kosovës lidhur me kërcënimet kryesore të brendshme në aspektin e sigurisë. Me qëllim të zbërthimit në mënyrë të plotë të perceptimeve të qytetarëve ndaj çështjeve që ata i konsiderojnë si më shqetësuese, matja e perceptimeve për kërcënimet e sigurisë është bërë duke iu ofruar mundësinë të anketuarve të përgjigjen në pyetje të hapura dhe pyetje të mbyllura. Rrjedhimisht, përmes pyetjeve të hapura të anketuarve iu kërkua që të tregonin se cilat janë rreziqet dhe kërcënimet me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës. Megjithatë, përgjigjet e marra nga të anketuarit në pyetjet e hapura ishin tejet të ngjashme me ato të pyetjeve të mbyllura.

Kërcënimet më të mëdha ndaj Kosovës të përmendura nga të anketuarit përmes pyetjeve të hapura lidheshin me situatën e tanishme socio-ekonomike dhe atë politike. Ngjashëm me vitin e 2018 të anketuarit më së shpeshti përmendën papunësinë, korrupsionin, Serbinë, krimin e organizuar, ndarjen e Kosovës, krimin ordiner dhe migrimin e të rinjëve nga Kosova si kërcënimet kryesore. Mirëpo, idetë e përfolura viteve të fundit lidhur me dialogun Kosovë-Serbi, siç janë ndarja e Kosovës si dhe shkëmbimi i territoreve në mes të Kosovës e Serbisë nuk ishin shqetësimet kyçe të qytetarëve në pyetjen e mbyllur.

Ndërkaq, në pyetjet e mbyllura, shumica dërmuese e të anketuarave e kanë renditur fenomenin e korrupsionit (91.41 për qind), papunësinë (90.97 për qind) dhe krimin e organizuar (89.3 për qind) si kërcënimet më të rrezikshme të brendshme për Kosovën. Vërehet se të anketuarit janë tejet të shqetësuar nga kërcënimi i sigurisë nga mungesa e sundimit të ligjit, gjegjësisht mungesa e rezultateve në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar nga institucionet e zbatimit të ligjit, përfshirë këtu policinë, prokurorinë dhe gjykatat. Krahas kësaj, duhet theksuar se qytetarët u shprehën të shqetësuar për ikjen e qytetarëve nga Kosova (86 pëe qind) dhe për ndotjen e ambientit në vend (80 për qind).<sup>3</sup>

BKS 2019 ka gjetur se të anketuarit kosovarë ndihen më të sigurt në shtëpitë/banesat e tyre dhe lagjet e tyre (88 për qind), krahasuar me qytetin (83 për qind) dhe Kosovën (61 për qind).<sup>4</sup> Krahas kësaj, në vitin 2019 ka pasur një rritje prej tre perqind tek të anketuarit që janë shprehur se ndihen të sigurt në shtëpitë e tyre, duke shënuar kështu një trend pozitiv sa i përket sigurisë në shtëpi.

3 Për më shumë analiza të kombinuara rreth rreziqeve ndaj sigurisë kombëtare, lexoni Raportin e QKSS-së Qendra Kosovare për studime të Sigurisë. Dialogu Kosove-Serbi: Shqyrtimi i perceptimeve të të anketuarve. Prishtinë: QKSS, 2020 [http://www.qkss.org/repository/docs/barometri2020-alb\\_2\\_628398.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/barometri2020-alb_2_628398.pdf)

4 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Barometri Kosovare i Sigurisë-Trendet e Perceptimeve të Qytetarëve për Sigurinë Publike në Kosovë (2016-2018). Prishtinë: QKSS, 2019 [http://www.qkss.org/repository/docs/KSB2018\\_Public-Safety\\_alb\\_final\\_\(2\)\\_486803.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/KSB2018_Public-Safety_alb_final_(2)_486803.pdf)






Figura 1. Kërcënimet kryesore të brendshme të sigurisë në pyetjen e hapur




Figura 2 - Shqetësimet kryesore të sigurisë socio-ekonomike




Figura 3. Përceptimi i Rrezikimit të Sigurisë nga mungesa e sundimit të Ligjit




Figura 4. Rreziqet më të mëdha të brendshme ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë.




Figura 5. Ekstremizmi i dhunshem si shqetësim kyç




Figura 6. Ndotja e ajrit t si shqetësim kyç




Figura 7. Ekstremizmi i dhunshëm si shqetësim i brendshëm



# RREZIQET NDAJ SIGURISË PUBLIKE NË KOSOVË

Migrimi i qytetarëve jashtë vendit ( 71 për qind), aksidentet e trafikut (60 për qind) dhe qentë endacak (58 për qind) radhiten si rreziqet më të larta të sigurisë publike sipas perceptimeve nga të anketuarit. Në anën tjetër, dhuna në familje renditet si dukuria që më së paku shihet si rrezik nga qytetarët (34 për qind) duke mbetur mbrapa dhunës në shkolla me 35 për qind dhe ngacmimeve seksuale me 37 për qind.

Shumica e të anketuarve, 71 për qind, e shohin migrimin e qytetarëve për shkak të gjendjes socio-ekonomike në vend si rrezik të madh për Kosovën. Për dallim nga pyetjet për rreziqet tjera ku të anketuarit në zonat urbane ishin më të shqetësuar, për këtë çështje të anketuarit në zonat rurale (rreth 75 për qind) u shprehën dukshëm më të shqetësuar se sa ata në zonat urbane (68 për qind). Përveç kësaj, vërehet se burrat e anketuar kanë tendencë të jenë më të shqetësuar nga ky fenomen se sa gratë.



## Migrimi i Qytetarëve Jashtë Vëndit




Figura 8. Përcëptimi publik ndaj migrimit si rrezik i lartë për sigurinë publike



Figura 9. Përcëptimi publik ndaj migrimit si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë




Figura 10. Përcëptimi publik ndaj migrimit si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës




Figura 11. Përcëptimi publik ndaj migrimit si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit

## Aksidentet e Trafikut

Më shumë se gjysma e të anketuarve ose 60 për qind e tyre janë shprehur se aksidentet e trafikut janë rrezik i nivelit të lartë për sigurinë publike në Kosovë. Të anketuarit në zonat urbane shprehën shqetësim më të madh

rreth aksidenteve të trafikut se ata në zonat rurale. Shqetësim më i madh u vërejt tek të anketuarit në rajonin e Pejës dhe Ferizajt ku 66 për qind e të anketuarëve shprehën shqetësim të lartë.




Figura 12. Përciptimi publik ndaj aksidenteve trafikore si rrezik i lartë për sigurinë publike




Figura 13. Përciptimi publik ndaj aksidenteve trafikore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë

Figura 14. Përciptimi publik ndaj aksidenteve trafikore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës




Figura 15. Përciptimi publik ndaj aksidenteve trafikore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësisë etnike




Figura 16. Përciptimi publik ndaj aksidenteve trafikore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit

## Qentë Endacak

Për sa i përket rrezikimit të sigurisë publike nga qentë endacakë, rreth 58 për qind e të anketuarve i konsiderojnë ata si rrezik. Shqetësim tejet më i madh për këtë çështje është vërejtur tek të anketuarit në zonat urbane (63 për qind) krahasuar me ata në zona rurale (50 për qind) me

dallim prej 13 përqind. Shqetësim më i madh është evidentuar në rajonin e Gjilanit (68 për qind) dhe në atë të Prishtinës (65 për qind). Ndërsa, gratë dolën të jenë më të shqetësuara nga qentë endacakë se sa të anketuarit burra.




Figura 17. Përceptimi publik ndaj qenve endacakë si rrezik i lartë për sigurinë publike




Figura 18. Përceptimi publik ndaj qenve endacakë si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë

Figura 19. Përceptimi publik ndaj qenve endacakë si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës




Figura 20. Përceptimi publik ndaj qenve endacakë si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësisë etnike




Figura 21. Përceptimi publik ndaj qenve endacakë si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit

## Fatkeqësitë Natyrore

Më shumë se gjysma e të anketuarve, përkatesisht 54 për qind e tyre i perceptojnë fatkeqësitë natyrore si rrezik të lartë të sigurisë publike. Të anketuarit nga popullsia me shumicë shqiptare (57 për qind) u shprehën më të shqetësuar për fatkeqësitë natyrore se të anketuarit nga komu-

niteti serb (për qind) dhe komunitetet tjera jo-shumicë (50 për qind). Ndërsa, në bazë të përbërjes gjinore, të anketuarat gra (60 për qind) i shohin fatkeqësitë natyrore si shqetësim shumë më të madh se të anketuarit burra (46 për qind).




Figura 22. Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike




Figura 23. Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë

Figura 24. Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës




Figura 25. Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësisë etnike




Figura 28. Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit

## Plaçkitja e Shtëpive dhe Banesave

Qytetarët në Barometrin 2019 dolën më të shqetësuar nga plaçkitja e shtëpive dhe banesave se sa vitin e kaluar. Përderisa në vitin 2018, rreth 53 përqind e të anketuarve ishin shprehur se i shohin plaçkitjet si rrezik të lartë, në vitin 2019 kjo përqindje ka kaluar në 56 përqind sosh me një rritje prej tre përqind. Të anketuarit në zonat urbane (57 përqind) janë lehtësisht më të shqetësuar se sa ata të zonave rurale (55 përqind) sa i përket kësaj dukurie.

Qytetarët në rajonin e Mitrovicës së Veriut (71 përqind) të ndjekur nga qytetarët e Prishtinës (61 përqind) kanë dalë të jenë më të shqetësuar nga ky fenomen. Në mënyrë të ngjashme sikurse me vitin 2018, edhe këtë vit Barometri ka regjistruar një shqetsim më të madh të burrave ndaj plaçkitjeve të shtëpive dhe banesave (57 përqind) krahasuar me të anketuarat gra (55 përqind).




Figura 29. Sa të rrezikuar ndihen te anketuarit nga plaçkitja e shtëpive/banesave



Figura 31. Sa të rrezikuar ndihen te anketuarit nga plaçkitja e shtëpive/banesave, sipas gjinisë




Figura 32. Sa të rrezikuar ndihen te anketuarit nga plaçkitja e shtëpive/banesave, sipas zonës




Figura 33. Sa të rrezikuar ndihen te anketuarit nga plaçkitja e shtëpive/banesave, sipas përkatësisë etnike




Figura 34. Sa të rrezikuar ndihen te anketuarit nga plaçkitja e shtëpive/banesave, sipas rajonit



## Armëmbajtja Pa Leje

Armëmbajtja pa leje paraqet një rrezik tjetër të lartë të sigurisë publike në Kosovë sipas të anketuarve. Për më tepër, gati gjysma e të anketuarve, 47 për qind, janë shprehur se e shohin posedimin e armëve pa leje si një rrezik të lartë të sigurisë publike. Të anketuarit në zonat urbane janë shprehur më të shqetësuar për këtë dukuri, ku përdherisa në zonat urbane 51 për qind e të anketuarëve e shohin armëmbajtjen pa leje si shqetësim për sigurinë publike, në zonat rurale kjo përqindje bie në 42 për qind. Ngjashëm me Përceptimin rreth vrasjeve, komuniteti serb në Kosovë

(78 për qind) dhe të anketuarit rajonin e Mitrovicën e Veriut (83 për qind) konsiderojnë armëmbajtjen pa leje si më problematike se sa të anketuarit shqiptarë dhe ata të rajoneve tjera. Po ashtu, siç duket, burrat kanë tendencë të ndihen më të kërcënuar se gratë nga armëmbajtja pa leje ku përdherisa rreth 53 për qind e burrave të anketuar shprehën shqetësim të lartë nga armëmbajtja pa leje, vetëm 43 përqind e grave shohin armëmbajtjen pa leje si kërcënim të lartë të sigurisë publike.




Figura 34. Përceptimi publik ndaj posedimit të armëve pa leje si rrezik i lartë për sigurinë publike




Figura 35. Përceptimi publik ndaj posedimit të armëve pa leje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë




Figura 36. Përceptimi publik ndaj posedimit të armëve pa leje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës




Figura 37. Përceptimi publik ndaj posedimit të armëve pa leje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësië etnike




Figura 38. Përceptimi publik ndaj posedimit të armëve pa leje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit

# Fajdet

Pothuajse gjysma e të anketuarve ose 45.67 përqind e tyre janë shprehur se fajdet paraqesin kërcënim të lartë të sigurisë publike. Në këtë mënyrë, sipas rezultateve të BKS-së, vërehen dallime të mëdha në perceptimet e qytetarëve në zonat urbane dhe rurale sa i përket kësaj dukurie. Përderisa vetëm 34 përqind të të anketuarve në zonat rurale kanë shprehur shqetësim për fajdet, rreth gjysma e të anketuarve në zona urbane, 48.5 për qind, kanë shprehur shqetësimin e tyre për fajdet si kërcënim të nivelit të lartë. Sa i përket perceptimeve të të anketuarve në bazë të

rajoneve të Kosovës, 56 përqind në rajonin e Gjilanit kanë dal të jenë të shqetësuar lidhur me dukurinë e fajdeve, duke rradhitur kështu Gjilanin si rajonin më të shqetësuar nga kjo dukuri. Ndërsa, lidhur me aspektin gjinor, është vërejtur një dallim prej 7 përqind tek të anketuarit burra dhe gra, gjegjësisht në njërën anë 42 përqind e grave i shohin fajdet si kërcënim të lartë, nga ana tjetër gjysma burrave të anketuar kanë shprehur shqetësim të lartë për këtë dukuri.




Figura 39. Përceptimi publik ndaj fajdeve si rrezik i lartë për sigurinë publike.




Figura 40. Përceptimi publik ndaj fajdeve si rrezik i lartë, sipas gjinisë




Figura 41. Përceptimi publik ndaj fajdeve si rrezik i lartë, sipas zonës




Figura 42. Përceptimi publik ndaj fajdeve si rrezik i lartë, sipas përkatësisë etnike




Figura 43. Përceptimi publik ndaj fajdeve si rrezik i lartë, sipas rajonit

## Vrasjet

Në vitin 2019 ka pasur një rritje të Përceptimit të vrasjeve si rrezik i lartë i sigurisë publike në Kosovë (rreth 40 për qind), krahasuar me vitin 2018 (35.6 për qind). Sipas rezultateve të BKS-së për vitin 2019, të anketuarit në zonat urbane ndihen më të kërcënuar nga vrasjet se sa të anketuarit që jetojnë në zonat rurale. Përderisa 44 për qind të të anketuarëve në zona urbane thanë se i shohin vrasjet si

kërcënim të lartë të sigurisë publike, në zonat rurale 35 për qind shprehën shqetësimin e tyre. Po ashtu, është vërejtur që të anketuarit nga radhët e komunitetit serb në Kosovë (rreth 65 për qind) si dhe të anketuarit në Mitrovicë e Veriut në veçanti (71 për qind) ndihen më të shqetësuar nga fenomeni i vrasjeve në krahasim me të anketuarit në rajonet tjera të vendit.




Figura 44. Përceptimi publik ndaj vrasjeve si rrezik i lartë për sigurinë publike



Figura 45. Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë




Figura 46. Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës




Figura 47. Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësisë etnike




Figura 48. Përceptimi publik ndaj fatkeqësive natyrore si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit

## Ngacmimet Seksuale

Sa i përket ngacmimeve seksuale, rreth 47.5 për qind e të anketuarve janë shprehur se ky fenomen paraqet rrezik të lartë të sigurisë publike. Të anketuarit nga komuniteti serb në Kosovë janë shprehur më të shqetësuar për këtë dukuri (rreth 58 për qind) se sa të anketuarit shqiptar (35 për qind) dhe pakicat tjera jo-serbe (36 për qind). Ndonëse

shumica e viktimave të ngacmimit seksual në Kosovë janë gra, sipas rezultateve të BKS-së, gratë e anketuara nuk kanë shprehur shqetësim më të theksuar rreth kësaj dukurie. 37 përqind të të anketuarëve gra dhe burra kanë thënë se i shohin ngacmimet seksuale si shqetësim të sigurisë publike.




Figura 49. Përceptimi publik ndaj ngacmimit seksual si rrezik i lartë për sigurinë publike




Figura 50. Përceptimi publik ndaj ngacmimit seksual si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë




Figura 51. Përceptimi publik ndaj ngacmimit seksual si rrezik i lartë për sigurinë publike, përkatësisë etnike




Figura 52. Përceptimi publik ndaj ngacmimit seksual si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit

## Dhuna në Shkolla

Vetëm 35 për qind e të anketuarve e shohin dhunën në shkolla si rrezik të lartë të sigurisë publike. Ajo që është e rëndësishme të theksohet janë dallimet e mëdha që ekzistojnë në mes të të anketuarve në zonat rurale dhe urbane. Në këtë mënyrë, derisa në vendbanimet urbane rreth 42

për qind e të anketuarve janë shprehur se rritja e dhunës në shkolla paraqet rrezik të lartë të sigurisë publike, ndërsa në vendbanime rurale vetëm 26 për qind e të anketuarve në zonat rurale e kanë përmendur si shqetësim këtë çështje.




Figura 53. Përciptimi publik ndaj dhunës në shkolla si rrezik i lartë për sigurinë publike




Figura 54. Përciptimi publik ndaj dhunës në shkolla si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë

Figura 55. Përciptimi publik ndaj dhunës në shkolla si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas zonës




Figura 56. Përciptimi publik ndaj dhunës në shkolla si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësisë etnike




Figura 57. Përciptimi publik ndaj dhunës në shkolla si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit

## Dhuna në Familje

Edhe pse gjatë vitit 2019 në Kosovë gjashtë gra ishin vrarë si pasojë e dhunës në familje,<sup>5</sup> vetëm 34 përqind e të anketuarve kanë shprehur shqetësimin e tyre rreth dhunës në familje si kërcënim të lartë të sigurisë publike. Si rrjedhojë, rezultatet e BKS-së kanë treguar se të anketuarit në zona urbane janë shumë më të shqetësuar (40 për qind) për këtë fenomen se sa të anketuarit në zonat rurale (27 për qind). Është vërejtur se të anketuarit nga radhët e komunitetit serb në Kosovë (64 për qind) janë më të shqetësuar

për dhunën në familje se të anketuarit shqiptar si popullatë shumicë ku vetëm 31 për qind kanë shprehur shqetësim për dhunën në familje si kërcënim të lartë të sigurisë publike. Nga ana tjetër, edhe pse shumica e viktimave të dhunës në familje janë gra,<sup>6</sup> sipas gjetjeve të BKS-së për vitin 2019, burrat megjithatë e shohin dhunën në familje si fenomen më të rrezikshëm se sa gratë e anketuara.




Figura 58. Përceptimi publik ndaj dhunës në familje si rrezik i lartë për sigurinë publike



5 Lexoni më shumë rreth vrasjeve të grave si rezultat i dhunës në familje në Ahmeti, N. "Dënimi me burgim të përjetshëm nuk i ndal vrasjet e grave në Kosovë." Radio Evropa e Lirë, Gusht 9, 2019. <https://www.evropalire.org/a/vrasja-e-grave-kosove-dhuna-familje/30101307.html>

6 Po aty;



Figura 59. Përceptimi publik ndaj dhunës në familje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas gjinisë




Figura 60. Përceptimi publik ndaj dhunës në familje si rrezik i lartë, sipas zonës




Figura 61. Përceptimi publik ndaj dhunës në familje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas përkatësisë etnike




Figura 62. Përceptimi publik ndaj dhunës në familje si rrezik i lartë për sigurinë publike, sipas rajonit

# PERCEPTIMET KUNDREJT REALITETIT

Ndjenja e sigurisë/pasigurisë së qytetarëve jo domosdoshmërisht reflekton rrezikun real nga ajo dukuri. Kjo ngase shpeshherë qytetarët ndihen më të kërcënuar për dukuritë që ata i shohin jashtë kontrollit të tyre dhe se dora si ka për qëllim të lëndoj tjetrin. Kjo e bën më të vështirë për t'u përgatitur apo mbrojtur nga këto dukuri. Megjithatë, rreziqet e perceptuara nga të anketuarit duhen trajtuar me seriozitet të njëjtë sikurse rreziqet reale me qëllim përmirësimin e sigurisë publike për të siguruar qytetarët dhe për t'i bërë ata të ndihen sigurt, pasi që frika nga këto dukuri ndikon në sjelljet e qytetarëve, ku disa njerëz shmangin disa hapësira publike si pasojë e frikës. Ky kapitull analizon ndërlidhjen e me kapitullin paraprak të perceptimeve të qytetarëve të anketuar nga BKS-ja me statistikat e publikuara nga PK-ja lidhur me numrin e rasteve të raportuara në fushën e sigurisë publike për çështje të caktuara.

Padyshim se armëmbajtja pa leje është pikënisje e shumë dukurive kriminale që drejtpërdrejtë ndikojnë në ndjenjën e sigurisë dhe pasigurisë së qytetarëve duke ndikuar këshu edhe në sigurinë publike. Sipas të dhënave të PK-së, në vitin 2018 u konfiskuan 1,470 armë të zjarrit pa leje dhe 24131 municion në Kosovë, ndërsa në vitin 2019 kishte një rënie në numrin e armëve të konfiskuara prej 1,439 sosh dhe 30,438 municion.<sup>7</sup> Nga dhjetori i vitit 2018, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka nisur fushatën për legalizimin e armëve të vogla dhe të lehta, të cilat i posedojnë pa leje qytetarët e Kosovës. Mirëpo, vetëm 1 mijë e 800 persona kanë aplikuar për legalizimin e armëve deri në fund të kësaj fushate që zgjati gjashtë muaj,<sup>8</sup> shifër kjo tejet e vogël në krahasim me numrin e armëve të zjarrit pa leje që supozohet të jenë në posedim nga ana e qytetarëve të ven-

dit.<sup>9</sup> Megjithatë, nuk është për t'u çuditur se ka një numër kaq të vogël të aplikimeve për legalizim të armëve si dhe një numër kaq të madh të armëmbajtjes pa leje. Në vitin 2018 u publikuan xhirime që treguan atëherë ish-zëvendëskryeminstri Dardan Gashi, ish-ministri e Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ish-kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku e të tjerë duke shtënë me armë automatike në ajër.<sup>10</sup> Ndërsa, ajo që është e bën edhe më të rëndë këtë situatë ishte se veprimet të tilla u arsyetuan nga ish-kryeministri Ramush Haradinaj si dhe ish-zëvendëskryeministri Fatmir Limaj nën pretendimin se "të shtënat me armë në ahengjet familjare janë traditë kanunore".<sup>11</sup> Një arsyetim i tillë nga udhëheqësit e atëhershëm të Qeverisë së Kosovës mund të ndikojë negativisht në anën tjetër tek qytetarët për përdorimin e armëve me potencial rrezikimin e sigurisë publike në vend. Armëmbajtja pa leje padyshim se mund të shpie në vetëgjyqësi si dhe në kërcënime të mëdha të sigurisë publike, si vrasjet e plaçkitjet e shtëpive dhe banesave.

Trendët e BKS-së tregojnë se ka rritje të Përceptimit të vrasjeve si rrezik të lartë për sigurinë publike. Përderisa në vitin 2018 rreth 35 përqind e të anketuarve ishin shprehur se vrasjet paraqesin kërcënim të lartë, në vitin 2019 kjo përqindje është rritur në 40 për qind, gjegjësisht ka një rritje prej 5 përqind

7 Jashari, F. "Për 260 mijë armë pa leje, vetëm 781 kërkesa për legalizim." Radio Evropa e Lire, Prill 30, 2019. <https://www.evropaelire.org/a/arme-pa-leje-legalizim-/29912708.html>

8 Po aty;

9 Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, rreth 260 mijë armë ilegale janë në posedim të qytetarëve. Kurse llogaritë të jenë afër 50 mijë armë legale, prej të cilave 22 mijë janë me leje të Republikës së Kosovës dhe 25 mijë armë të tjera që kanë pasur leje nga ish-administrata e UNMIK-ut e që po i nënshtrohen procesit të legalizimit. Lexoni më shumë në Alihajdaraj, D. "Legalizimi i ngadalshëm i armëve pa leje në Kosovë." Radio Evropa e Lire, Mars 10, 2019 <https://www.evropaelire.org/a/legalizimi-i-ngadalshem-i-armeve-pa-leje-kosove/29811195.html>

10 Krasniqi, H. "Dardan Gashi, Endrit Shala, Sami Lushtaku e të tjerët dënohen me gjobë për gjuajtjen me armë në odën e Fatmir Limajt." Betimi për Drejtësi, March 1, 2019 <https://betimiperdrejtesi.com/dardan-gashi-endrit-shala-sami-lushtaku-e-te-tjeret-denohen-me-gjobe-per-gjuajtjen-me-arme-ne-oden-e-fatmir-limajt/>

11 "Pamje të reja tregojnë se para Limajt gjuhet edhe me automatik." Koha.net, Janar 29, 2018. <https://www.koha.net/arberi/72336/pamje-te-reja-tregojne-se-para-limajt-gjuhet-edhe-me-automatik/>



gjithsej nga viti 2018 në vitin 2019. Në anën tjetër, statistikat e PK-së tregojnë për ulje të numrit të vrasjeve. Sipas raportit vjetor të PK-së, 34 vrasje kanë ndodhur gjatë vitit 2018, ndërsa në vitin 2019 ky numër ka rënë në 23 sosh.<sup>12</sup> Siç duket, ky trend në rritje i Përceptimit të të anketuarve për vrasjet si rrezik i lartë për sigurinë publike ndërlihet edhe me raportimet e shumta në media për vrasje gjatë vitit 2019.<sup>13</sup> Për më tepër, gjatë viteve të fundit vrasjet kanë qenë të ndërlihdura edhe me plaçkitjet e shtëpive, banesave si dhe bankave.

Sipas gjetjeve të BKS-së, ka një trend në rritje të Përceptimit të plaçkitjes së shtëpive dhe banesave si sfidë për sigurinë publike në vend. Në vitin 2019, BKS-ja ka vërejtur një rritje prej tre për qind, nga 53 në 56, të Përceptimit të plaçkitjes së shtëpive dhe banesave si kërcënim të lartë. Mirëpo, të dhënat e PK-së flasin për një rënie të numrit të vjedhjeve, vjedhjeve të rënda si dhe grabitjeve gjatë vitit 2019.<sup>14</sup> Kjo mungesë e lidhshmërisë në mes të numrit të rasteve të plaçkitjes së shtëpive dhe banesa si dhe përceptimit të kësaj dukurie si sfidë të lartë të sigurisë publike lë hapsirë për interpretimin e arsyeve që shpien në një përceptim të tillë nga publiku. Sigurisht kjo rritje e Përceptimit të plaçkitjeve si kërcënim i lartë kur kemi një ulje të numrit të e plaçkitjeve lidhet me raportimet e shpeshta në media për plaçkitje të shtëpive, banesave e bankave krahas me besueshmërinë në institucionet e drejtësisë.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, personat që kapen duke kryer vjedhje grabitqare dënohen me tre deri në dhjetë vite burg.<sup>15</sup> Mirëpo, Barometri vetëm se ka regjistruar një ulje të besueshmërisë së qytetarëve në organet e dre-

jtësisë në Kosovë, gjë që lë të nënkuptohet se qytetarët nuk kanë besim që institucionet e drejtësisë do të zbardhnin raste të ndryshme, përfshirë këtu edhe vjedhjet.<sup>16</sup> Në të vërtetë, ky mosbesim në zbardhjen e këtyre rasteve të shumta është tejet i rëndësishëm pasi që mund të shpie në marrjen e drejtësisë në duar, vetëgjyqësi, përkatësisht vrasjen e personave që kanë qenë duke kryer veprën penale të vjedhjes nga ana e personave të cilët kanë qenë pre e këtyre vjedhjeve apo grabitjeve, përderisa shpeshherë rastet e tilla janë raportuar si vetëmbrojtje apo mbrojtje e pronës. Në nëntor të vitit 2018, ndodhi një vrasje në lagjen Veternik, Prishtinë ku pronari i shtëpisë qëlloi me armë personin që kishte hyrë të kryente vjedhje, kështu duke e lënë të vdekur.<sup>17</sup> Po ashtu, në muajin gusht të vitit 2019 pronari i një shtëpie vrau grabitësin që i kishte hyrë në shtëpi.<sup>18</sup>

Sipas nenit 12 të Kodit Penal, vepra e kryer në mbrojtje të nevojshme nuk është vepër penale.<sup>19</sup> Mbrojtje e tillë është akt i domosdoshme për të tejkaluar sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atij momenti ndaj vetes ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi.<sup>20</sup> Mirëpo, është e rëndësishme të theksohet se në rast të tejkalimit të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, vepra e tillë pastaj hyn në sferën penale. Kur bëhet fjalë për raste të tejkalimit të kufijve të mbrojtjes së

12 Raporti i Policisë së Kosovës për Vitin 2018 dhe 2019

13 "Këto janë vrasjet më të rënda që u kryen gjatë këtij viti në Kosovë." Periskopi, Prill 22, 2019 <https://www.periskopi.com/keto-jane-vrasjet-me-te-renda-qe-u-kryen-gjate-ketij-viti-ne-kosove/>

14 Sipas Raporteve të Policisë së Kosovës për Vitin 2018 dhe 2018, në 2018 kishte 5842 vjedhje dhe ky numër ra në 4519 në 2019 (rënie 22.64%). Po ashtu, në 2018 kishte vjedhje të rënda 4774, numër ky që ra në 3803 në 2019 (rënie 20.33%). Tek grabitjet kishte një ulje të numrit të grabitjeve nga 297 në 171 në vitin 2019 (42.42%). Lexoni më shumë në Hiseni, I dhe Shefqeti, S. Raporti Vjetor 2019. Prishtinë: n.p, 2019 <https://www.kosovopolice.com/wp-content/uploads/2020/02/Raporti-vjetor-2019-shqip.pdf>

15 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2/14 Janar 2019, Prishtinë. Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

16 Gjatë vitit 2018, vetëm 27 përqind e të anketuarve për BKS-në raportuan se i besojnë gjykatave dhe vetëm 31 përqind kanë shprehur besimin e tyre në prokurori. Ndërsa, në vitin 2019 vetëm 21 përqind shprehën besimin e tyre në gjykata dhe vetëm 29 përqind të të anketuarëve u shprehën se i besojnë prokurorisë. Për më shumë lexoni Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Barometri Kosovari i Sigurisë-Edicioni i nëntë. Prishtinë: QKSS, 2019 [http://www.qkss.org/repository/docs/BKS2019\\_874685.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/BKS2019_874685.pdf)

17 Lexoni [https://indeksonline.net/vrasje-ne-prishtine-pronari-i-shtepise-qellon-me-arme-hajnin/?fbclid=IwAR17R0L4JrM0PEXq4q3qJr2bcUAT7b5tM7s6yUPJ0\\_OEYfrDj8Y2aE9c](https://indeksonline.net/vrasje-ne-prishtine-pronari-i-shtepise-qellon-me-arme-hajnin/?fbclid=IwAR17R0L4JrM0PEXq4q3qJr2bcUAT7b5tM7s6yUPJ0_OEYfrDj8Y2aE9c) dhe "Arianit Koci: Kur duhet ta vrasim hajnin." Gazeta Blic, Mars 4, 2020 <https://gazetablic.com/arianit-koci-kur-duhet-ta-vrasim-hajnin/>

18 "Shtime: Pronari vret hajnin që i hyri në shtëpi." InfoGlobi, Gusht 7, 2019 <https://infoglobi.com/shtime-pronari-vret-hajnin-qe-i-hyri-ne-shtepi/> Lidhur me dënimin lexoni <https://insajderi.com/gjykata-merre-vendimi-per-burrin-qe-vrau-hajnin-ne-shtepi-ne-shtime/>

19 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2/14 Janar 2019, Prishtinë. Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

20 Po aty;

nevojshme, sipas nenit 172 të Kodit Penal, "Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim".<sup>21</sup>

Prona private në Kosovës është e drejtë që garantohet me aktet më të lartë juridike në vend. Krahas kësaj, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, prona private në mënyrë specifike njihet dhe mbrohet përmes nenit 46, i cili e garanton të drejtën për të poseduar pronë.<sup>22</sup> Në mënyrë të ngjashme, edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut e cila është thelbësore dhe njëanshmërisht e aplikueshme në Kosovë (ndonëse Kosova ende nuk është anëtarësuar në Këshillin e Evropës) i kushton rëndësi të drejtës së pronës. Por, nga ana tjetër, duhet theksuar se e drejta e jetës tejkalon çdo të drejtë tjetër dhe qëndron si një e drejtë parësore e pamohueshme dhe asnjë e drejtë, përfshirë atë të pronës, nuk ka më shumë peshë se kjo e drejtë.<sup>23</sup>

Ndonëse në vitin 2018 vetëm 35 për qind e të anketuarve e kanë parë dhunën në familje si rrezik të lartë të sigurisë publike dhe në vitin 2019 vetëm 34 për qind të të anketuarëve kanë shprehur shqetësim të lartë lidhur me dhunën në familje si kërcënim të lartë ndaj sigurisë publike, PK-ja ka raportuar për një rritje për rreth 25 përqind të rasteve të raportuara për dhunën në familje. Derisa në vitin 2018 kishte 1,540 raste të raportuara për dhunën në familje, në 2019 ky numër u rrit në 1,915 sosh<sup>24</sup> që është një rritje prej 374 rasteve të raportuara në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018. Sidoqoftë, duhet theksuar se rritja e numrit të raportimeve nuk do të thotë që ka rritje të rasteve të dhunës në familje, por kjo rritje e raportimit të rasteve të dhunës në familje ngërthen në vete disa arsye. Një nga arsyet e tjera pse më herët ka pasur më pak raste të raportuara mund të jete edhe fakti se viktimat e dhunës në familje kanë qenë të frikësuara ose kërcënuara

nëse raportojnë këto raste, mirëpo, vëmendja mediatike e rasteve të dhunës në familje i ka shtyer viktimat të raportojnë për këto raste. Krahas kësaj, sipas Njësitit të Dhunës në Familje në PK, kjo rritje mund të ketë ardhur si rrjedhojë e faktit se procedurat e PK-së për raportim janë përmirësuar e që mund të ketë rritur besimin në PK dhe përfundimisht ka kontribuar në rritjen e shkallës së rasteve të raportuara.<sup>25</sup> S'do mend se nismat avokuese të disa organizatave dhe aktivistëve për të drejtat e grave, krahas protestat të vazhdueshme kanë kontribuar në ngritjen e përgjithshme të ndërgjegjësimit të viktimave të dhunës në familje drejt raportimit të rasteve.<sup>26</sup>

Gjatë viteve 2018 dhe 2019, rreth 60 për qind e të anketuarve kanë thënë se i shohin aksidentet e trafikut rrugor si rrezik tejet të lartë ndaj sigurisë publike në Kosovë. Megjithatë, edhe pse kjo përqindje e Përceptimit mbetet e njëjtë, statistikave e PK-së tregojnë për një rritje prej 2.17 përqind të numrit të aksidenteve në trafikun rrugor, ku ky numër u rrit nga 15,877 sa ishin më 2018 në 16,222 aksidente më 2019, gjegjësisht ka pas rritje prej 345 aksidenteve më shumë.<sup>27</sup> Megjithatë, vërehet se ka pasur rënie të numrit të personave të vdekur në aksidentet e trafikut nga 129 në vitin 2018 në 113 në vitin 2019, pra ka rënie prej 16 rasteve kur krahasohen të dhënat e vitit 2019 me ato të vitit 2018.<sup>28</sup> Në anën tjetër, PK-ja ka raportuar për një ngritje prej 11.03 për qind të numrit të gjobave të shqiptuara në trafik.<sup>29</sup> Paralelisht, PK-ja, në vitin 2019, ndërmori planin operativ "Drejtimi i automjetit nën ndikimin e alkoolit" i cili në fokus kishte vozitësit në gjendje të dehur, ndaj të cilëve u shiptuan gjoba si dhe u konfiskuan patentë shoferët.<sup>30</sup>

21 Po aty;

22 Kuvendi i Kosovës. "Kushtetuta e Republikës së Kosovës". Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>

23 "Universal Declaration of Human Rights". United Nations. <https://www.un.org/en/universal-declaration-human-rights/>

24 Të dhëna e siguruar nga Policia e Kosovës. Lexoni më shumë rreth trendit të raportimit të dhunës në familje në Morina, D. Dhuna në Baza Gjinore në Kosovë-Shqyrtim kritik i reagimit të policisë .Prishtinë:ERAC,2019. [http://kgscenter.net/site/assets/files/1742/gender\\_base\\_violence\\_alb-1.pdf](http://kgscenter.net/site/assets/files/1742/gender_base_violence_alb-1.pdf) si dhe në

25 Dhuna në baza gjinore në Kosovë: Shqyrtim kritik i reagimit të policisë, Morina, D. Dhuna në Baza Gjinore në Kosovë-Shqyrtim kritik i reagimit të policisë .Prishtinë:ERAC,2019 [http://kgscenter.net/site/assets/files/1742/gender\\_base\\_violence\\_alb-1.pdf](http://kgscenter.net/site/assets/files/1742/gender_base_violence_alb-1.pdf)

26 Po aty;

27 Hiseni, I dhe Shefqeti, S. Raporti Vjetor. Prishtinë: n.p, 2019 <https://www.kosovopolice.com/ep-content/uploads/2020/02/Raporti-vjetor-2019-shqip.pdf>

28 Po aty;

29 Po aty;

30 "110 gjakovarë mbesin pa patentë shoferi shkaku i Alkoolit". Insajderi. Gusht, 2019 <https://insajderi.com/110-gjakovare-mbesin-pa-patente-shofere-shkaku-i-alkoolit/>

# PERIMETRI I SIGURISË

Perimetri i sigurisë është një nga treguesit më të rëndësishëm të BKS-së. Çdo vit, të anketuarit janë pyetur sa të sigurt ndihen në shtëpitë, lagjet, fshatrat e tyre, dhe në përgjithësi në Kosovë. QKSS-ja e përdor këtë instrument si

mjet për hartëzimin e perimetrit virtual të sigurisë, si dhe për të identifikuar nivelet mikro dhe makro ku qytetarët ndihen të pasigurt, të sigurt dhe më të sigurt.<sup>31</sup>




Figura 63. Sa të sigurt ndihen te anketuarit në shtëpinë/banesën, lagjen, qytetin/ fshatin e tyre

31 Përfaqësimi vizual i të dhënave përqendrohet në përqindjen e sigurisë dhe jo të pasigurisë

BKS 2019 ka gjetur se të anketuarit kosovarë ndihen më të sigurt në shtëpitë/banesat e tyre dhe lagjet e tyre (88 për qind), krahasuar me qytetin (83 për qind) dhe Kosovën (61 për qind).<sup>32</sup> Krahas kësaj, në vitin 2019 ka pasur një rritje prej tre perqind tek të anketuarit që janë shprehur se ndihen të sigurt në shtëpitë e tyre, duke shënuar kështu

një trend pozitiv sa i përket sigurisë në shtëpi. Po ashtu, vërehet se ka rritje tek të anketuarit që u shprehen se ndihen më të sigurt në lagjet e tyre,<sup>33</sup> duke pasur kështu një përqindje të njëjtë të ndjenjës së sigurisë në shtëpi dhe lagje (88 për qind).




Figura 64. Sa të sigurt ndihen te anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas zonës



Figura 65. Sa të sigurt ndihen te anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas përkatësisë etnike




Figura 66. Sa të sigurt ndihen te anketuarit në shtëpinë/banesën e tyre, sipas rajonit

32 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Barometri Kosovar i Sigurisë, Trendet e Përceptimeve të Qytetarëve për Sigurinë Publike në Kosovë (2016-2018). Prishtinë: QKSS, 2019 [http://www.qkss.org/repository/docs/KSB2018\\_Public-Safety\\_alb\\_final\\_\(2\)\\_486803.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/KSB2018_Public-Safety_alb_final_(2)_486803.pdf)

33 Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Barometri Kosovar i Sigurisë, Trendet e Përceptimeve të Qytetarëve për Sigurinë Publike në Kosovë (2016-2018). Prishtinë: QKSS, 2019. Në vitin 2018, 84 për qind të të anketuarëve thanë se ndihen të sigurtë në lagjet e tyre [http://www.qkss.org/repository/docs/KSB2018\\_Public-Safety\\_alb\\_final\\_\(2\)\\_486803.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/KSB2018_Public-Safety_alb_final_(2)_486803.pdf)




Figura 67. Sa të sigurt ndihen te anketuarit në lagjen e tyre, sipas gjinisë




Figura 68. Sa të sigurt ndihen te anketuarit në lagjen e tyre, sipas zonës




Figura 69. Sa të sigurt ndihen te anketuarit në lagjen e tyre, sipas përkatësisë etnike




Figura 70. Sa të sigurt ndihen te anketuarit në lagjen e tyre, sipas rajonit

Përgjatë edicioneve të BKS-së është vërejtur se ndjenja e sigurisë ulet atëherë kur të anketuarit ekspozohen në mjedisë në makro-nivel, siç janë fshatrat, qytetet dhe Kosova në përgjithësi. Qytetarët raportuan se ndihen më pak të sigurt në fshatrat ose qytetet e tyre në krahasim me shtëpitë ose lagjet e tyre.<sup>34</sup> Megjithatë, përqindja e të anketuarve që raportuan se ndihen të sigurt në qytetet/fshatrat e tyre po rritet gradualisht. Në këtë mënyrë, derisa në vitin 2018, rreth 79 për qind e të anketuarve u shprehën se se ndiheshin të sigurt në qytetin e tyre, në vitin 2019, pothuajse 84 për qind e të anketuarve u përgjigjën se ndihen të sigurt në fshatin apo qytetin e tyre.

Shumica e të anketuarëve nuk e perceptojnë si të rrezikshëm qytetin/ fshatin ku banojnë. Për më tepër, pesë nga gjashtë të anketuar ndjehen shumë të sigurt në qytetin/ fshatin ku jetojnë. Gjakova, Peja dhe Mitrovica listohen si rajonet ku pjesa dërmuese e të anketuarve kanë thanë se ndjehen tejet të sigurt (rreth 89 për qind sosh). Ndërkaq, rajoni i Mitrovicës së Veriut jep një pasqyrë tjetër ku vetëm gjysma e të anketuarve janë deklaruar se ndjehen shumë të sigurt në qytetin e tyre.




Figura 71. Sa të sigurt ndihen te anketuarit në qytetet/fshatrat e tyre, sipas zonës




Figura 72. Sa të sigurt ndihen te anketuarit në qytetet/fshatrat e tyre, sipas rajonit

34 Për më shumë rreth trendit të perimetrit të sigurisë lexoni Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Barometri Kosovar i Sigurisë, Trendet e Përceptimeve të Qytetarëve për Sigurinë Publike në Kosovë (2016-2018). Prishtinë: QKSS, 2019 [http://www.qkss.org/repository/docs/KSB2018\\_Public-Safety\\_alb\\_final\\_\(2\)\\_486803.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/KSB2018_Public-Safety_alb_final_(2)_486803.pdf)

Ndjenjat e konfuzionit dhe pasigurisë vërehet kur të anketuarit pyeten nëse ndihen të sigurt ose të pasigurt në Kosovë, në përgjithësi. Kjo pasi që në ambientin makro qytetarët e lidhin ndjenjën e sigurisë/pasigurisë më shumë me dukuritë dhe rreziqet të aspektit socio-ekonomik dhe mungesën e stabilitetit politik, të diskutuara në kapitullin e parë, të cilat i shohin si rreziqe jashtë kontrollit të tyre. Mirëpo, duhet theksuar se në 2019, ka pasur një rritje të

lartë tek të anketuarit që janë shprehur se ndjehen të sigurt në Kosovë. Ndonëse në vitin 2018 rreth 52 përqind e të anketuarve thanë se ndihen të sigurt në Kosovë, ndërsa në vitin 2019, rreth 61 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se ndjehen të sigurt në Kosovë. Pra, ka pasur një rritje prej nëntë përqind në vitin 2019 në raport me vitin 2018 sa i përket ndjenjës së sigurisë në Kosovë.




Figura 73. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në Kosovë (niveli kombëtar), sipas gjinisë




Figura 74. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në Kosovë (niveli kombëtar), sipas zonës




Figura 75. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në Kosovë (niveli kombëtar), sipas përkatësisë etnike




Figura 76. Sa të sigurt ndihen të anketuarit në Kosovë (niveli kombëtar), sipas rajonit

# PRITSHMËRITË NË INSTITUCIONET: REKOMANDIMET



**Institucionet duhen të zotohen në largimin e armëve ilegale nga duart e qytetarëve;**

Duhet të ketë një regjistrim adekuat dhe kontroll të numrit të armëve legale, si dhe të vendoset kontroll më i madh i institucioneve në rrafshin e armëve ilegale me qëllim të uljes së numrit të armëve pa leje. Krahas kësaj, natyrisht se duhet të aplikohen dënime më të rënda edhe për mbajtjen e paligjshme të armës, por duhet të ketë ndëshkime edhe kur ka prova për përdorimin e armës pa leje. Kjo, po ashtu, do të ndikonte në rënien e numrit të rreziqeve të sigurisë publike që vijnë si pasojë e armëmbajtjes pa leje. Krahas kësaj, duhet të bëhet ose dorëzimi i armëve ose konfiskimi i tyre për të ulur numrin e posedimit të armëve pa leje.



**Institucionet duhet të punojnë në rritjen e ndriçimit publik;**

Ndriçimi i hapësirave publike ndikon në rritjen e ndjenjës së sigurisë së qytetarëve me që rritja e ndriçimit publik ul rrezikun nga dukuritë të cilat e cenojnë sigurinë publike, si dhe ndikon në rritjen e ndjenjës së sigurisë për të lëvizur gjatë orëve të natës, me theks të veçantë për gratë. Përveç që duhet të vendoset ndriçimi publik në të gjitha hapësirat publike, po ashtu institucionet përgjegjëse për këtë çështje duhet të mirëmbajnë rregullisht pajisjet e ndriçimit publik.



**Rritja e pranisë së Policisë së Kosovës nëpër lagje;**

Qytetarët shumë shpesh kanë shprehur shqetësimet e tyre se në rrugë/lagje nuk ka prani të policëve në rrugë/lagje, gjë që krijon një mjedis tolerant për kundërvajtje dhe krime të llojeve të ndryshme. PK-ja ka Strategjinë e Policimit në Bashkësi dhe Planin e Veprimit 2018-2021, që synon të vë në funksion konceptin e policimit të lagjes.<sup>35</sup>Krahas kësaj, zbatimi i fuqishëm projektit Policimi në Bashkësi është tejet i rëndësishëm për afrimin e zyrtarëve policor me lagjen<sup>36</sup> për të rritur ndjenjën e sigurisë publik tek qytetarët.



**Vendosja e kamerave të sigurisë në hapësirat publike në të gjitha rajonet e Kosovës;**

Gjatë viteve të kaluara është raportuar për shumë raste kur kamerat e bizneseve private si dhe ato të vendbanimeve kanë

35 Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës. Strategjia dhe Plani i Veprimit 2017-2021. Prishtinë: n.p.n.d [https://www.kosovopolice.com/ep-content/uploads/2019/10/1\\_Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_2017-2021\\_-\\_Policimi\\_n%C3%AB\\_Bashk%C3%ABsi\\_-pdf](https://www.kosovopolice.com/ep-content/uploads/2019/10/1_Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_2017-2021_-_Policimi_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_-pdf)

36 [https://www.kosovopolice.com/ep-content/uploads/2019/10/1\\_Strategjia\\_dhe\\_Plani\\_i\\_Veprimit\\_2017-2021\\_-\\_Policimi\\_n%C3%AB\\_Bashk%C3%ABsi\\_-pdf](https://www.kosovopolice.com/ep-content/uploads/2019/10/1_Strategjia_dhe_Plani_i_Veprimit_2017-2021_-_Policimi_n%C3%AB_Bashk%C3%ABsi_-pdf)



ndihmuar procesin e hetimeve.<sup>37</sup>Duke pasur parasysh që çdo vit ka një numër të madh të aksidenteve të trafikut, vendosja e kamerave në nivel të rrugëve rajonale, magjistrale dhe autostradë do të ndihmojë PK-në në identifikimin e automjeteve dhe personave që përfshihen në raste, qofshin ato penale apo edhe raste civile të kundërvajtjeve. Për më shumë, edhe zyrtarë të PK-së kanë konfirmuar se kamerat e sigurisë do t'i lehtësonin punën organeve të rendit dhe hetuesisë, pasi që në mungesë provash, shumë raste kanë mbetur pa u zbardhur nga institucionet e zbatimit të ligjit. Megjithatë, PK-ja thekson se vendosja e kamerave të sigurisë nuk është përgjegjësi e tyre, por e qeverisjeve në nivel lokal dhe qendror.<sup>38</sup> Padyshim, vendosja e kamerave duhet të bëhet krahas dhe bazuar në Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.<sup>39</sup> Para vendosjes së kamerave të sigurisë, institucionet përkatëse duhen të zotohen se do të bëhet ruajtja e të dhënave të mbledhura për t'u mos u cenuar privatësia e qytetarëve ose palëve



tjera, ndërsa siguria e këtyre të dhënave do të mbrohet nga sulmet apo vjedhjet e mundshme. Po ashtu, qytetarët duhen të sigurohen se këto të dhëna nuk do të përdoren për asgjë tjetër.

### Modernizimi i Qendrës së Thirrjeve në PK;

Rrjeti i urgjencës u krijua për linjat fikse. Megjithatë, modernizimi i 192 është tejet i rëndësishëm për sigurinë individuale, si dhe atë publike. Linjat tradicionale të emergjente të PK-së deri më tani nuk mund të pranojnë fotografi, video, thirrje nga aplikacioni i Skype. Në raste të ndryshme të emergjencave, rrjetet sociale kanë funksionuar edhe atëherë kur linjat fikse nuk kanë punuar ose kanë qenë të mbingarkuara.<sup>40</sup> Për më tepër, modernizimi i linjave emergjente do të mundësonte bashkëpunim më të mirë të PK-së me qytetarët pasi që ata do të mund të dërgonin foto e video duke shtuar një dimension në atë se si përdoruesi mund t'i përgjigjet çështjeve të sigurisë. Ta zëmë, ndërsa shumica e njerëzve do t'i thërrasin shërbimet e urgjencës për ndihmë nëse do të dëshmojnë një aksident të rëndë me makinë, shumë nga ta do të regjistronin foto ose video nga aksidenti të cilat mund t'i ndajnë me shërbimet e urgjencës për t'u dhënë atyre një ide më të mirë të situatës në terren.

37 Një shembull i tillë është rasti i vrasjes së Ilir Zeqirit, ku pamjet nga kamerat e sigurisë së bizneseve private dhe ato në kompleksin memorial të familjes Jashari në Prekaz, të Skenderajt, u bënë shkak për arrestimin e dy personave si të dyshuar për vrasjen e Ilir Zeqirit. Për më tepër Jashari, F. "Mungesa e kamerave në dëm të sigurisë dhe hetimeve", Radio Evropa e Lirë, Prill 22, 2019 <https://www.evropaelire.org/a/mungesa-e-kamerave-ne-dem-te-sigurise-dhe-hetimeve/29896663.html>

38 Po aty;

39 Sipas ligjit për të dhëna personale të dhënat, incizimet në këtë rast, mund të përpunohen apo të shfrytëzohen për qëllime të tjera, vetëm nëse janë të nevojshme për të parandaluar kërcënimet ndaj shtetit dhe sigurisë publike, apo për të ndjekur penalisht krimet." Megjithatë, vëzhgimi me kamerë dhe regjistrimet e vëzhgimit duhet të mbrohen në mënyrë të duhur nga qasja dhe përdorimi i paautorizuar. Për më tepër, lexoni KREU XVI të Ligjit Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale: Kuvendi i Kosovës. "Ligji nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale". Gazeta e Republikës së Kosovës. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18616>.

40 Pas tërmetit dhe tsunamit të 11 Marsit në Japoni, miliona njerëz komunikuan përmes rrjeteve sociale, kur linjat fikse binin dhe rrjetet mobile nuk punuan. Brenda një ore nga tërmeti, më shumë se 1200 tweets në minutë po vinin nga Tokio, duke përfshirë azhurnimet e videos në skenë.



### **Institucionet e sigurisë duhen të rrisin bashkëpunimin me qytetarët përmes rrjeteve sociale dhe aplikacioneve për përmirësim të sigurisë publike;**

PK-ja vetëm se ka filluar të shkëmbej informacione, të mbledh informata në bashkëpunim me qytetarët, të bashkëpunoj në përgjigjet ndaj incidenteve në faqen e tyre zyrtare në Facebook e kështu me radhë. Megjithatë, edhe pse shumë organe shtetërore në shtete të ndryshme kanë krijuar aplikacione të ndryshme për të kontribuar në rritje të sigurisë publike,<sup>41</sup> një gjë e tillë ende nuk ka ndodhur në Kosovë. Deri më sot, nismat e vetme për raportimin dhe ndarjen e informacioneve rreth rreziqeve të sigurisë publike kanë ardhur nga vet qytetarët përmes grupeve të ndryshme në rrjete sociale dhe aplikacioneve të ndryshme.<sup>42</sup> Rritja e përdorimit të internetit në Kosovë shpie po ashtu në rritjen e pritshmërive të qytetarëve për përfshirjen e institucioneve përkatëse në shfrytëzimin e këtyre shërbimeve dhe reagimin e këtyre të fundit në kohë reale. Përderisa shumë qytetarë kërkojnë informacione në rrjete sociale, përdorimi i aplikacioneve dhe mediave sociale për komunikim mund të rrisë rrjedhën e informacionit midis autoriteteve të qytetit dhe qytetarëve gjë që mund të ndikojë në

parandalimin si dhe luftimin e dukurive të dëmshme ose që paraqesin rrezik e shqetësim serioz për sigurinë publike. Prandaj, qytetarët kanë pritshmëri të larta ndaj institucioneve të sigurisë publike sa i përket përmirësimit të përdorimit të teknologjisë për të plotësuar praninë fizike të personelit të urgjencës.



### **Duhet të vazhdoj programi i Kapjes, Sterilizimit, Vaksinimit si dhe Lëshimit (KSVL) për qentë në baza vjetore;**

Vazhdimi i programit KSVL është i domosdoshëm për kontrollimin e numrit dhe mirëqenjes së qenve endacak në Kosovë. Në vitin 2018 u realizua programi i KSVL 2018 që bëri kastrimin, sterilizim, vaksinimin dhe më pas lëshimin e qenve endacakë. Megjithatë, në mungesë të vazhdimsisë së një projekti të tillë në vitin 2019, situata e qenve endacakë është kthyer siç ka qenë më herët. Kjo ka shpër në një situatë ku në mënyrë të vazhdueshme ka tufa të reja të qejeve endacakë të cilët janë të pa kastuar/sterilizuar kështu duke rritur edhe më shumë numrin e qenve endacak. Krahas kësaj, shumimi i qenve në rrugë bënë që ata të kenë jetë të vështirë, ku shpesh edhe keqtrajtohen nga njerëzit, gjë që pastaj paraqet rrezik për shëndetin dhe sigurinë publike po ashtu. Në maj të 2020 ka filluar projekti emergjent për menaxhimin dhe kontrollin e qenve endacakë në Kosovë, që pritet të përfundoj në prill 2021. S'do mend se vazhdimi i këtij programi duhet të bëhet me një mbikëqyrje të plotë të procesit, duke u siguruar që qentë të kthehen në territoret ku janë marrur para trajtimit, në mënyrë që të evitohen luftrat në mes të tufave për territore, që më pas ndikojnë edhe në siguri të qytetarëve.

41 Artikulli <https://www.data.gov/safety/safety-apps> një përmbledhje të aplikacioneve të sigurisë publike në SHBA që ndihmojnë në situata të ndryshme. Data.Gov."Open government data powers software applications that help people make informed decisions on public safety." <https://www.data.gov/safety/safety-apps>

42 Aplikacioni #EcShlirë është një aplikacioni mobil për të raportuar ngacmimet seksual. Të dhënat e mbledhura nga ky aplikacion shfrytëzohen për të përkahur masa preventive. Lexo më shumë <http://www.ecshlire.com/> EcShlirë."Aplikacion mobil për të raportuar ngacmimin seksual. Të dhënat e mbledhura do të shfrytëzohen për të përkahur masa preventive." <http://www.ecshlire.com/>

# METODOLOGJIA E BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË 2019

Barometri Kosovari i Sigurisë (BKS) është një program i veçantë i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) i krijuar në shtator të vitit 2012. Qëllimi i tij kryesor është që të mat besimin e publikut ndaj institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë si dhe të mat perceptimin e qytetarëve lidhur me kërcënimet e brendshme dhe të jashtme që i kanosen Kosovës.

BKS është aktiviteti i parë dhe më i madhi i këtij lloji i dizajnuar, zbatuar dhe komunikuar nga një forum lokal në Kosovë. Duhet theksuar se ajo që e bën unik BKS në Kosovë është neutraliteti i tij politik. Si një forum i pavarur, QKSS nuk ka kufizime politike në komunikimin e çfarëdo gjetjeje dhe mesazhi të hulumtimit.

BKS përdor kombinim të metodave cilësore dhe sasore që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme. Të dhënat e tij mbledhen përmes intervistave personale me të anketuarit e përzgjedhur në mënyrë të rastësishme që zhvillohen nga hulumtuesit e QKSS në terren anembanë Kosovës. Pyetësi i QKSS përbëhet kryesisht nga pyetje të mbyllura në formë të Shkallës pesë-pikëshe të Likertit, që pasoheshin me disa pyetje të hapura që u mundësonin të anketuarve të japin mendimet e tyre pa u dhënë opsione të paracaktuara të përgjigjeve.



Ekipi i QKSS prej 29 hulumtuesve ka bërë pilotimin dhe intervistat. Mostra në nivel vendi nga të cilat u nxor ky hulumtim përfshinte 1,189 familje, duke përbërë kështu një mostër përfaqësuese të popullsisë mbi moshën 18 vjeçe në Kosovë. Përkatësia etnike e personave të intervistuar ishte: 89 për qind shqiptarë të Kosovës, 7.4 për qind serbë dhe 2 për qind të tjerë (turq, boshnjakë, romë, ashkali, egjiptian dhe goran) që reflektonin përbërjen etnike të Kosovës. Korniza e mostrës bazohej në zona sipas kodeve hyrëse telefonike dhe si e tillë përfshinte këto tetë rajone: Ferizajn, Gjakovën, Gjiilanin, Mitrovicën Jugore, Mitrovicën Veriore, Pejën, Prishtinën dhe Prizrenin.

Faza e parë e grupimit gjeografik bazohej në Raportin e Regjistrimit të Popullsisë 2012. Faza e dytë përfshinte grupimin e mostrave për zona komunale me mostër të stratifikuar rurale/urbane sipas numrit të familjeve. Faza e fundit u zhvillua sipas metodës së caktimit të rastësishëm të mostrës duke përdorur 'metodën e ditëlindjes' më të afërt.


Caktimi i rastësishëm i mostrës siguron që secili banor i Kosovës të ketë gjasë të barabartë që të zgjidhet për intervistë. Me mostrën e zgjedhur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë trendët e qëndrimeve dhe perceptimeve në mesin e tërë popullsisë së rritur të Kosovës në përgjithësi. Margjina e gabimit është 3 për qind me interval të besueshmërisë prej 95 përqind.

Një intervistë testuese u zhvillua në fund të muajit shtator për të testuar sa është i plotë pyetësi para fillimit të punës në terren. Ekipi hulumtues pastaj raportoi se intervista testuese ishte e suksesshme dhe se nuk ishin hasur probleme me instrumentin testues. Të gjitha intervistat u kryen nga 9 tetor deri më 16 tetor 2019. Të dhënat u për-


punuan dhe analizuan duke përdorur softuerin SPSS. Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmblendhje e informacioneve të marra nga të anketuarit dhe ai demonstroi se si njerëzit i perceptojnë institucionet kosovare.




### Të anketuarit sipas gjinisë




### Të anketuarit sipas Zonës së Vendbanimit



### Hulumtimi në terren



### Mosha



Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351(496.51)(047)

Marku, Donika

Barometri kosovar i sigurisë : sfidat e sigurisë publike në Kosovë / Donika Marku. -  
Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2020. - 40 f. ; 21 cm.

**ISBN 978-9951-799-08-9**



[www.qkss.org](http://www.qkss.org)

ISBN 978-9951-799-08-9



9 789951 799089